

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 135, dt. 16.07.2015

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, "*Për Trashëgiminë Kulturore*", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 16.07.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,


VENDOSI:

1. Miratimin e projektit të zbatimit për ndërtimin e Hec-eve Xhuxhë 1 dhe Xhuxhë 2 në kaskadën e përroit të Zall Xhuxhës, degë e lumit Fan i Vogël, Rrethi Mirditë, Qarku Lezhë.
2. Ngarkohet shoqëria të kontribuojë për restaurimin e monumentit Ujësjiellësi i Domgjonit, sipas projekt-preventivit të hartuar nga DRKK-ja Shkodër.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore punimet të mbikqyren nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI